



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

---

OLIMPIADA KOMBËTARE E HISTORISË PËR ARSIMIN E MESËM TË LARTË

Viti shkollor 2021-2022

Faza e tretë

ZGJIDHJET

## **Pyetja 1      8 pikë**

Idetë iluministe konsiderohen si një prej bazave ideologjike kryesore të Revolucionit Francez. Në veçanti, teoria e "kontratës shoqërore", qeverisja legjitime dhe e arsyeshme ishin ndër shtyllat e mendimit iluminist. Qeverisja shihej jo si një e "drejtë hyjnore" por si legjitimitet i dhënë nga populli. Qeverisja mund të kontestohet nga populli nëse vërehet se ajo binte në kundërshtim me "kontratën shoqërore".

Gjithashtu, shoqëria njerëzore duhet të udhëhiqet nga arsyeja, racionaliteti dhe progresi shkencor.

Në origjinën e tij, revolucioni francez ishte pikërisht një revoltë ndaj një qeverisje dhe pushteti absolut që shkonte në kundërshtim me interesat e shtresave të gjera të popullit, pra që ishte jo i legjitimuar nga vullneti i këtij të fundit.

Problemi qëndron në faktin që, me gjithë arritjet, revolucioni francez nuk çoi në një formë qeverisje kushtetuese dhe, për pasojë, kishte mungesë demokracie dhe legjitimiteti. Periudha diktatoriale që kulmoi me Terrorin e Robespierit dhe ardhja në pushtet e Napoleon Bonapartit që përqendroi gjithë pushtetin duke u shpallur perandor, i dhanë goditjen përfundimtare ideve iluministe si frymëzim për qeverisjen.

## **Pyetja 2      8 pikë**

Idetë dhe procesi i Reformacionit që inicioi Martin Luther ishte një nismë revolucionare në kuadër të kishës katolike. Ai goditi shumë prej privilegjeve të deriatëhershme të kishës, duke kërkuar ndryshime të thella në mënyrën e funksionimit dhe të raportit të saj me besimtarët. Këto e bëjnë atë një figurë revolucionare. Idetë e tij u përhapën në të gjithë Evropën.

Në vende të ndryshme lindën dhe u përhapën grupe të shumtë të përkrahësve të ideve të tij. Në Francë, ata u quajtën hygenotë, në Zvicër kalvinistë sipas emrit të Kalvinit që përfaqëson figurën kryesore që propogandoi idetë reformatore të Lutherit në Zvicër, krahas Zvinglit, ndonëse me disa nuanca disi të ndryshme. Po kështu, përhapje pati edhe në mjaft vende të tjera si në Holandën e sotme, vendet skandinave etj.

Nga ana tjetër, në periudhën e Reformacionit, pati lëvizje të mëdha fshatare në funksion antifeudal. Në këto përplasje mes fshatarëve dhe feudalëve, Luther mori anën e feudalëve. Ai, jo vetëm nuk i përkrahu fshatarët që kërkonin të drejtat e tyre, por i sulmoi ata.

Pra, nga pikëpamja shoqërore Martin Luther qëndroi në pozita konservatore.

### **Pyetja 3      10 pikë**

Përfundimi i Luftës II Botërore, përveç fitores mbi nazi-fashizmin, solli një situatë të re lidhur me ndarjen e saj në dy kampe politiko-ushtarake. Kundërvënia mes tyre u përqendrua në planin politik, ideologjik dhe ekonomik. Në planin ushtarak, kundërvënia mbeti në nivel konkurrence dhe kërkim ekuilibri mes blloqeve por nuk u shndërrua asnjëherë në një konfrontim të hapur luftarak.

Aktorët kryesorë ishin organizatat e Traktatit të Varshavës dhe NATO (në planin ushtarak) dhe Tregut të Përbashkët Evropian dhe KNER në atë ekonomik. Sigurisht që shtetet më të rëndësishme në kuadër të këtyre organizatave ishin SHBA dhe BRSS.

Kundërvënia mes blloqeve pati momente tensioni, të alternuara me momente zbutje relative. Konkurrenca u zhvillua në drejtimet ideologjike, ushtarake (gara e armatimeve), ekonomike (për të provuar epërsinë e sistemeve respektive) dhe politike. Fakti që nuk pati konfrontim të hapur ushtarak nuk do të thotë që nuk pati situatë përplasje apo prag përplasje.

Ndër momentet e para pikat kyçe ku shprehej tensioni ishte Lufta Civile në Greqi ku u përplasën qeveria monarkiste greke (e mbështetur nga Britania e Madhe dhe SHBA) me forcat komuniste (të mbështetura nga BRSS dhe Blloku Lindor komunist).

Lufta e Koresë apo ajo e Vietnamit ishin ngjarje të tjera ku u shpreh rivaliteti mes superfuqive dhe kampeve respektive.

Një situatë tjetër ishte kriza e raketave në Kubë ku u arrit në një prag përplasje bërthamore mes superfuqive.

Një ndër pikat kulmore ku shprehej tensioni mes blloqeve ishte edhe qyteti i ndarë i Berlinit (dhe Gjermania në përgjithësi). Si një pikë kulmore në këtë kuadër mund të konsiderohet ndërtimi i Murit të Berlinit që për një periudhë për disa dekada u bë simboli i ndarjes së kontinentit evropian.

### **Pyetja 4      4 pikë**

#### ***Luftërat fetare në Francë      4 pikë***

Feja dhe politika shpesh janë ndërthurur në konflikte të ndryshme duke e bërë të paqartë se ku fillonte njëra e ku mbaronte tjetra.

Në përgjithësi elementi politik dhe pushteti kanë përbërë bazën e konflikteve por jo rrallë prezent ka qenë edhe një komponent fetar.

Luftërat fetare në Francë i referohen konfliktit mes përkrasësve të katolicizmit dhe atyre të rrymës protestante. Ky konflikt vazhdoi me ndërprerje dhe përfshirje edhe të vendeve të tjera (Spanjës) deri në shpalljen e Ediktit të Nantës në 1598 që garantoj lirinë fetare të protestantëve.

**Luftërat fetare në Angli 4 pikë**

Lufta civile në Angli erdhi si pasojë e përplasjes mes mbretit Karli I dhe parlamentit për supremaci politike. Në këtë kuadër, ka qenë prezent edhe një komponent fetar pasi mbreti ishte i fesë katolike ndërsa përkrahësit e parlamentit ishin në shumicën e tyre të rrymës anglikane (kisha kombëtare angleze).

**Lufta Tridhjetëvjeçare në Evropë 4 pikë**

Lufta Tridhjetëvjeçare ishte një ndër konfliktet më të përgjakshme në historinë evropiane. Ajo është e përbërë nga konflikte të ndryshme, për arsye të ndryshme fetare, dinastike, territoriale apo tregtare. Duke përgjithësuar, konflikti ishte mes Perandorisë së Shenjtë Romake nën drejtimin e dinastisë Habsburge (katolike) dhe një aleance mes një rrjeti qytetesh mesjetare, Suedisë dhe Holandës (protestantë).

## Pyetja 5

a) 4 pikë

*E veçanta*

- Sipas Statutit Organik kryetari më i lartë i administratës civile e ushtarake ishte princ Vidi, ndërsa Statuti i Lushnjës krijoi Këshillin e Lartë prej 4 vetash në formë regjence si kreu më i lartë i shtetit, i përbërë nga përfaqësues të 4 komuniteteve fetare
- Sipas Statutit Organik organi legjislativ ishte Asambleja Kombëtare, ndërsa Statuti i Lushnjës krijoi Këshillin Kombëtar të quajtur Senat me funksione legjislative

*Të përbashkëta*

- Nuk përcaktuan fe zyrtare
- Garantuan të drejtën e pronës

b) 4 pikë

*E përbashkëta:*

- Sanksionoi shtetin laik
- Sanksionoi ndarjen e pushtetit në ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor.

*Të veçantat:*

- Sipas Statutit Themeltar të Republikës së Shqipërisë (1925), parlamenti do të kishte dy dhoma: senatin dhe dhomën e deputetëve, ndërsa sipas Statutit Themeltar të Mbretërisë së Shqipërisë, senati u shkri dhe në parlament mbeti vetëm dhoma e deputetëve
- Sipas Statutit Themeltar të Republikës së Shqipërisë (1925), Shqipëria shpallej republikë parlamentare, ndërsa sipas Statutit Themeltar të Mbretërisë së Shqipërisë (1925), Shqipëria u shpall "Mbretëri Demokratike parlamentare dhe trashëgimore"

c) **4 pikë**

- Kushtetua e vitit 1946 njihje të drejtën e pronës private dhe trashëgiminë e saj. Kushtetuat e vitit 1976, e ndalonte pronën private.
- Në kushtetutën e vitit 1946 tregtia me jashtë kontrollohej nga shteti, ndërsa në kushtetutën e vitit 1976, ishte monopol i shtetit.
- Kushtetua e vitit 1946 njihje të drejtën e ushtrimit të lirë të fesë dhe mbrojtjen e komuniteteve fetare. Kushtetua e vitit 1976 e ndalonte fenë dhe e shpallte vendin ateist.
- Kushtetuta e vitit 1946, i njihje të drejtën të gjithë shtetasve të fjalës së lirë, manifestimit, grumbullimit etj. Në kushtetutën e vitit 1976, e drejta e shtetasve kufizohet vetëm në të mundësinë e ankimeve e propozimeve, duke hequr të drejtën e lirisë së fjalës, shtypit, manifestimit, demonstrimit apo grumbullimit publik.